



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 7814/prot.

Vlorë, më 22.10 2018

VENDIM

Nr. 108, Datë, 18.10, 2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT
TË STRUKTURËS VENDORE TË APELIMIT TATIMOR NË BASHKINË VLORE
SI DHE PROCEDURAVE PÛRKATËSE TË APELIMIT**


Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, neni 8, neni 9, neni 35, neni 36, neni 54, ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë“, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe në relacionin e Administratës së Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës

VENDOSI

1. Të miratojë “Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor në Bashkinë Vlorë si dhe Procedurat Përkatëse të Apelimit” sipas tekstit bashkalidhur këtij projekt vendimi, hartuar nga Drejtoria Juridike dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë
2. Komisioni Vendor i Apelimit të Bashkisë Vlorë, si strukturë të përbëhet nga 5 anëtar dhe emërimi i anëtarëve të komisionit bëhet me vendim të Kryetarit të Bashkisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, neni 55, pika 6.

KRYETARI

Vojsava Shkurtaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS VENDORE TË APELIMIT TATIMOR NË BASHKINË VLORË SI DHE PROCEDURAVE PËRKATËSE TË APELIMIT

OBJEKTI

Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të strukturës vendore së apelimit tatimor në Bashkinë Vlorë

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi nga Bashkia Vlorë i rregullave të qëndrueshme për ndjekjen e procedurave të ankimimit administrativ për taksat e tarifat vendore, duke përfshirë specifikisht taksën e ndërtesës.

Kjo rregullore hartohet bazuar në:

1. Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
2. Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqerisjen Vendore”;
3. Ligji nr. 10297, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”
4. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar;
5. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
6. Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
7. VKM nr. 132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

Në rast ndryshimi të ndonjë prej akteve ligjore dhe nënligjore referuese ndryshimi duhet të reflektohet edhe në këtë Rregullore.

PËRMBAJTJA

1. Organizimi i Komisionit Vendor të Apelimit Administrativ të Taksave e Tarifave Vendore
 - 1.1. Zgjedhja e Kryetarit të Komisionit
 - 1.2. Kompetencat dhe Detyrat e Komisionit të Apelimit
 - 1.3. Organizimi dhe procedura për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit
2. Objekti i Apelimit administrativ në nivel vendor
 - 2.1. Akti administrativ i vlerësimit të pasurisë së paluajtshme/ndërtesë, si dhe korrigjimi i të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës së ndërtesës në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, qëllimin e përdorimit dhe çmimet përkatëse
 - 2.2. Akti administrativ i Drejtorisë/Zyrës së Taksave dhe Tarifave për vlerësimin e Taksave dhe Tarifave vendore..
 - 2.3. Çdo akt administrativ apo mosveprim për nxjerrjen e një akti administrativ nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
3. *Aktet që NUK mund të ankimohen në Komisionin e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore*
4. Kriteret formale të Ankimit Administrativ Vendor
5. Veprimet e Ndërmarra nga Komisioni i Apelimit
6. Afati i shqyrtimit të Ankimit në Komisionin e Apelimit dhe e Drejta e Ankimit të Taksapaguesit Kundër Vendimit të Kësaj Strukture
7. Rimbursimi i Detyrimit Tatimor Vendor në Rastet e Parapagimit në Procesin e Ankimit Administrativ
8. Ekzekutimi i Vendimit të Komisionit Vendor të Apelimit dhe Apeli në Gjykatë

1- ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT VENDOR TË APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Bazuar në specifikat e procedurave për vlerësimin e taksave dhe tarifave vendore si dhe për të mundësuar ndjekjen e procedurës te apelimit administrativ te taksave e tarifave vendore, ne Bashkinë Vlorë krijohet dhe funksion Komisioni i Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Komisioni i Apelit përbëhet nga jo më shumë se 5 anëtarë te cilet jane punonjës të departamenteve të ndryshme të Drejtorive juridike/ligjore, Taksave dhe Tarifave Vendore, Urbanistikes si dhe një nënkryetar Bashkie .

Komisioni ngrihet me vendim të Kryetarit të Bashkisë me një mandat 1 vjeçar me të drejtë riemërimi. Në rast të nevojës për ndryshim/zëvendësim të anëtarëve të komisionit, Kryetari i Bashkisë bën ndryshimin/zëvendësimin e anëtarit përkatës me një punonjës tjetër.

Të paktën një punonjës i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore shërben si Sekretar Administrativ i Komisionit. Sekretari Administrativ duhet të jetë i diplomuar në shkenca ekonomike ose juridike, të ketë njohuri të mira në nivel teknik mbi legjislacionin tatimor si dhe të ketë të paktën 2 vite përvojë pune në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Anëtarët e Komisionit Vendor të Apelit Tatimor duhet të jenë të diplomuar në degë përkatëse të përshtatshme me funksionin dhe veprimtarinë e këtij komisioni si dhe të kenë të paktën 2 vite përvojë pune në fushën përkatëse.

1.1. ZGJEDHJA E KRYETARIT TE KOMISIONIT

Si organ kolegjal me të drejtë vote, Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, e cila mbahet brenda 7 ditësh pune nga data e daljes së vendimit të Kryetarit të Bashkisë, zgjedh Kryetarin dhe Sekretarin administrativ. Propozohen të paktën dy anëtarë për t'u zgjedhur si kryetar dhe nëpërmjet votimit, kryetar zgjidhet anëtari që merr 50 përqind të votave plus 1 votë, pra 3 vota. Në rast se nuk arrihet zgjedhja e Kryetarit dhe Sekretarit, pasi asnjëri nuk merr votat e mjaftueshme, edhe pas raundit të dytë të votimit, atëhere ata emërohen në detyrë nga Kryetari i Bashkisë me vendim të posaçëm.

Kryetari dhe anëtarët e komisionit mund të ndryshohen në çdo kohë, në rastet kur:

- a. nuk marrin pjesë në tri mbledhje radhazi të komisionit, pa shkaqe të justifikuara;
- b. japin dorëheqjen;
- c. janë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi (Në këtë rastme vendim të Kryetarit të Bashkisë, për efekt të plotësimit të kuorumiit në vendimarrje, anëtari që është në konflikt interesi, zëvendësohet përkohësisht)
- d. përfundojnë marrëdhënien e punës me Bashkinë Vlorë
- e. bëhen të paafte nga ana shëndetësore për të kryer funksionet e ngarkuara;

1.2 KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT VENDOR TË APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

I. Kryetari i Komisionit i cili është një nga anëtarët, ushtron këto detyra:

- a. cakton datën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së komisionit dhe vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje;
- b. drejton zhvillimin e mbledhjeve të komisionit;
- c. mbikqyr veprimtarinë e sekretarit të komisionit;
- d. cakton anëtarin/anëtarët që do të relatojnë ankimin për shqyrtim nga Komisioni në mbledhjen e radhës;
- e. raporton për ecurinë e veprimtarisë së Komisionit pranë Kryetarit të Bashkisë brenda muajit dhjetor të çdo viti ose sa herë i kërkohet prej tij;
- f. nënshkruan vendimet e Komisionit, në përputhje me parashkimet e Kodit të Procedurave Administrative.

II. Anëtarët e Komisionit ushtrojnë këto detyra:

- a. marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komisionit dhe njoftojnë paraprakisht në rast mungese duke paraqitur dhe arsyet e mungesës;
- b. votojnë për çështjet e rendit të ditës, bazuar në parimin e profesionalizmit dhe ndershmërisë;
- c. deklarojnë, para votimit të çdo çështjeje, nëse janë në kushtet e konfliktit të interesit;
- d. secili prej anëtarëve relaton para komisionit çështjen e caktuar;
- e. ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.
- f. nënshkruajnë vendimet e Komisionit, në përputhje me parashkimet e Kodit të Procedurave Administrative.

III. Sekretari Administrativ i Komisionit ushtron këto detyra:

- a. meri në dorëzim ankimet që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimarrjes së Komisionit;
- b. shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
- c. njofton kryetarin e komisionit për çdo ankimim të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të ankimit;
- d. njofton ankimuesin të paktën 7 ditë pune përpara për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit.
- e. mban dhe harton procesverbalin e mbledhjes;
- f. zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit.

1.3 ORGANIZIMI DHE PROCEDURA PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE TE KOMISIONIT

Komisioni mbledhet me kërkesën Kryetarit ose e të paktën 2 anëtarëve të tij, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e depozitimit të ankimit. Rendi i dites dhe data e mbledhjes caktohet nga kryetari dhe u njoftohet anëtarëve të komisionit/nëpërmjet sekretariatit, të paktën shtatë ditë pune përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj.

Mbledhja e Komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë të komisionit. Kur kjo shumicë nuk është arritur, caktohet një datë tjetër, brenda tri ditëve pune. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë, çdo anëtar dhe ankimuesi apo përfaqesuesi i tij. Komisioni mund të mbledhet më shumë se një herë për të njëjtën çështje sipas nevojës.

Vendimet në çdo rast merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Komisionit të pranishëm në mbledhje. Komisioni merr vendime vetëm për kërkesa për apelim, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal me shkrim, i cili është një përmbledhje të gjithë procesit: datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, arsyetimi, vendimet që u morën, si dhe rezultati i votimeve.

Procesverbali mbahet nga sekretariati dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët në përfundim të mbledhjes ose në fillimin e mbledhjes pasardhëse.

2- OBJEKTI I APELIMIT ADMINISTRATIV NE NIVEL VENDOR

Është objekt apelimi administrativ pranë Komisionit Vendore të Apelit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore çdo akt administrativ apo mosveprim për nxjerrjen e një akti administrativ nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me një taksë dhe/ose tarifë vendore.

2.1. Akti administrativ i vlerësimit të pasurisë së paluajtshme/ndërtesë, për qëllime të taksës së ndërtesës

Taksapaguesit subjekt të taksës së ndërtesës, kanë të drejtë të kundërshtojnë administrativisht në strukturën përkatëse, Drejtorinë/Zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë vlerësimin e bërë nga autoritetet përkatëse të vlerës së pronës për kategorinë ndërtesë, fillimisht duke paraqitur një Kërkesë për Korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, qëllimin e përdorimit të ndërtesës dhe çmimeve përkatëse. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet edhe në rast se ankimuesi gjykon se ndërtesa e tij është objekt përjashtimi nga ligji. Nëse taksapaguesi nuk bie dakord me vendimin e strukturës përkatëse/Drejtorisë ose Zyrës së Taksave/ose Agjentit të mbledhjes së taksës ndaj kërkesës për korrigjim, atëherë ai ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit Vendor të Apelit Administrativ të Taksave dhe Tarifave.

Taksapaguesi, ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e detyrimit në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë nuk është bërë në përputhje me parashikimet e VKM nr.

132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” apo kur ky vlerësim ka pasaktësi përsa i takon të dhënave të përdorura.

Taksapaguesi, pas marrjes së njoftimit të detyrimit për taksën e pasurisë, kur nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korrigjimin e vlerës:

- a) në Drejtorinë/zyrën e taksave dhe tarifave vendore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme “ndërtesë”;
- b) në zyrën e agjentit të mbledhjes së taksës, për rastet kur në këto zyra, shërbimi i korrigjimit ofrohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore me punonjësit e saj.

Për të disiplinuar dhe unifikuar procedurat e korrigjimit, taksapaguesit plotësojnë një formular tip¹ dhe që është pjesë e Rregullores. Formulari i plotësuar shoqërohet gjithnjë me dokumentacionin justifikues e plotësues.

Drejtoria/Zyra e Taksave Vendore, brënda 30 (tridhjetë) ditëve, bën shqyrtimin e kërkesës së subjektit dhe vendos:

1. Të pranojë kërkesën për korrigjim dhe bën korrigjimin e vlerës nëse vlerësimi fillestar është bazuar mbi të dhëna të gabuara apo ka gabime në përlllogaritje;
2. Të refuzojë kryerjen e korrigjimit dhe arsyeton me vendim arsyet e refuzimit të kërkesës për korrigjim.

Procedurat e korrigjimit, **NUK** kushtëzohen me ndonjë detyrim nga ana e tatimpaguesit për të parapaguar taksën për të cilën është bërë kërkesa për korrigjim.

2.2. Ankimi administrativ pranë Komisionit Vendor të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave.

Taksapaguesi ka të drejtë, që nëse nuk është dakord me vendimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me kërkesën e tij për korrigjim, të ankimojë këtë vendim pranë Komisionit Vendor të Apelimit, brënda një afati prej 30 ditësh nga data kur është marrë apo konsiderohet të jetë marrë njoftimi.

Kanë të drejtë të paraqesin ankim pronarët e ndërtesës/njesisë pronësore apo përdoruesit e saj, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” dhe zhvilluesit të cilët nuk arrijnë të përfundojnë ndërtimin brenda afateve të përcaktuara në lejen përkatëse, të lëshuar nga autoriteti përkatës i planifikimit.

Taksapaguesi mund të ankimojë taksën mbi pasurinë e paluajtshme/ndërtesë pasi vlerësimi i taksës së pasurisë nuk është i drejtë si rezultat i:

1. Të dhënave të pasakta;
2. Vendndodhjes së pasurisë dhe çmimeve përkatëse,
3. Normës tatimore të pasaktë, bazuar në qëllimin e përdorimit të pasurisë
4. Dhe çdo arsye tjetër që ndikon në detyrimin e tij tatimor.

Komisioni Vendor i Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me ankimin e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme/ndërtesë kryen këto detyra:

- a. Planifikon dhe mban mbledhje të rregullta për shqyrtimin e ankimimeve, brenda një periudhe prej 30 ditë kalendarike, nga dita e pranimit të ankimimeve;
- b. Mund të kërkojë praninë e ankimuesit, për dëgjim para këtij Komisioni për të sqaruar arsyen e ankimit dhe për të sjellë çfarëdo dokumenti apo prove që mund ta mbështesë ankimin;
- c. Mund të kërkojë të dhëna shtesë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore apo nga zyra e agjentit për mbledhjen e taksës;
- d. Mund të inspektojë pronën e paluajtshme, kur vlerësohet se një veprim i tillë është në shërbim të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Komisioni Vendor i Apelit merr vendim duke:

1. Refuzuar ankimin për shkak se e konsideron të papranueshëm për mungesë të kriterëve formale sipas pikës 4 të kësaj Rregulloreje;
2. Lënë në fuqi aktin administrativ objekt apelimi ;
3. Shfuqizuar aktin administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë/Zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë për të reflektuar ndryshimet në Regjistrin Qendror të bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme (Kadastër);
4. Shfuqizuar pjesërisht aktin administrativ objekt apelimi dhe njofton Drejtorinë/ Zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë për të reflektuar ndryshimet në Kadastër.

2.3.Çdo akt administrativ apo mosveprim për nxjerrjen e një akti administrativ nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Sipas nenit 7 të Ligjit “Për sistemin e taksave vendore”, taksapaguesi ka të drejtë të ankimojë kundër:

- a) çdo akt administrativ të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore,
 - b) çdo veprimi apo mosveprimi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
- nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
- i. që ka të bëjë me taksapaguesin.
 - ii. që ndikon në detyrimin e tij të taksave dhe tarifave vendore.

Akt administrativ konsiderohen të gjitha aktet e nxjerra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore që **shkaktojnë efekte financiare dhe/ose ligjore** për çdo taksapagues individualisht.

Vendimet administrative që mund të ankimohen përfshijnë çdo njoftim vlerësimi apo akt tjetër administrativ që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit, përfshirë llogaritjen e gjobave dhe/ose gabimet në llogaritjen kamatëvonesës.

Ankimi mund të bëhet edhe kundër një mosveprimi, d.m.th. një mosveprimi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit (p.sh. një akt që nuk është miratuar nga Njësia e Vetqeverisjes Vendore ose Këshilli Bashkiak brenda periudhës së përcaktuar në ligj, pavarësisht nëse taksapaguesi ka bërë kërkesë në lidhje me të.)

Ankimi mund të bëhet nga vetë taksapaguesi apo nga përfaqësuesi i tij dhe mund të përfshijë apelimin e disa vendimeve administrative në të njëjtën procedurë.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankimit, Komisioni Vendor i Apelit, ka të drejtë të grupojë së bashku disa ankime të ngjashme me qëllim të maksimizimit të efikasitetit në procedurën e ankimit.

3. Aktet që NUK mund të ankimohen në Komisionin e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore

Aktet që NUK mund të ankimohen pranë Komisionit Vendor të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore janë:

- a. Aktet e Komisionit Vendor të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, që rezultojnë nga procedura e ankimit NUK mund të jenë objekt ankimi administrativ. Këto vendime MUND të ankimohen vetëm në gjykatë.
- b. Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore që nuk ndikojnë në detyrimin tatimor vendor të taksapaguesit;
- c. Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore që shkelin të drejtat e tatimpaguesve sipas Ligjit "Për procedurat tatimore";
- d. Masat administrative të mbledhjes me forcë të detyrimeve.

Në përputhje me parashikimin e nenit 92, kreu XI të Ligjit "Për procedurat tatimore", masat administrative të parashikuara sipas këtij kreu dhe në kapituj të tjerë të këtij ligji, që kanë të bëjnë me masat e mbledhjes me forcë, nuk janë objekt apeli administrativ pranë Komisionit Vendor të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Megjithatë:

Taksapaguesi ndaj pasurisë së të cilit ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë, në formën e barrës sigurorese apo hipotekore, ka të drejtë të paraqesë ankesë tek Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, vetëm në ato raste kur zbatimi i masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt.

Konsiderohet se ekzekutimi i Vendimit për marrjen e masave të sigurisë nuk është kryer në rregull në rastet e mëposhtme:

- a) kur taksapaguesi nuk ka pasur njoftim me shkrim për sigurimin e detyrimit tatimor, brenda afateve kohore të parashikuara nga Ligji “Për procedurat tatimore”;
- b) kur gjatë periudhës së daljes së vendimit dhe ekzekutimit të tij, detyrimi tatimor vendor është paguar;
- c) nëse pasuria e vendosur si barrë sigurorese apo hipotekore, është në grupin e sendeve mbi të cilat nuk mund të shtrihet ekzekutimi sipas nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile;
- d) kur akti me anë të të cilit kërkohet të veprohet për ekzekutimin për mbledhjen me forcë të taksave dhe tarifave vendore ka dalë jo në emër të taksapaguesit por kundrejt një personi tjetër.

Akti administrativ i konfiskimit i mbajtur sipas nenit 122 pika 4 të ligjit “Për procedurat tatimore”, në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative ankimohet administrativisht tek Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, apo drejtuesi më i lartë i Zyres së Taksave Vendore sipas organizimit të NJQV.

Taksapaguesi, në rast se ka konstatuar parregullsi në ekzekutimin e vendimit, e ushtron të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të tyre.

Në çdo rast, në ankesën e tij, taksapaguesi është i detyruar t'i provojë Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore momentin se kur ai ka marrë dijeni për një parregullsi, gjë e cila duhet të provohet me anë të provave shkresore.

Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore , në përfundim të shqyrtimit, brenda 30 ditëve kalendarike prej marrjes së kërkesës, vendos:

1. Të refuzojë kërkesën nëse nuk është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh nga data e konstatimit të parregullsisë;
2. Të lërë në fuqi vendimin e masës sigurorese, barrë sigurorese apo barrë hipotekore.
Kundër këtij vendimi, taksapaguesi mund të ankimojë tek Komisioni Vendor i Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore;
3. Të shfuqizojë plotësisht apo pjesërisht vendimin e masës sigurorese, barrë sigurorese apo barrë hipotekore.

4. KRITERET FORMALE TË ANKIMIT ADMINISTRATIV TATIMOR VENDOR

a. Afati i ankimit

Ankimi duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur akti administrativ është marrë ose konsiderohet të jetë marrë. Njoftimi konsiderohet të jetë marrë nga taksapaguesi brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike pas pranimit të dokumentit nga shërbimi postar.

Në rastet kur dita e fundit e afatit bie në ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

Në qoftë se, në kundërshtim me ligjin, në aktin administrativ mungon njoftimi që informon taksapaguesin për të drejtën e tij për të ankimuar aktin administrativ, përfshirë afatin dhe hallkën e apelimit, taksapaguesi mund të ankimojë brenda 3 (tre) muajve nga data kur akti administrativ është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë prej tij.

Në rast mosveprimi të administratës tatimore (refuzimi për të nxjerrë një akt), procedura e ankimit fillon tre muaj pas ditës së dorëzimit të kërkesës fillestare për nxjerrjen e aktit administrativ.

Në qoftë se ankimi pranë Komisionit Vendor të Apelimit nuk bëhet brenda afatit të caktuar, ai konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

Taksapaguesi mund të kërkojë rivendosjen në afat vetëm nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme respektimi i afatit procedural. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet dorëzuar edhe ankimi pranë Komisionit Vendor të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

b. Ankimi bëhet me shkrim

Ankimi duhet të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ankimuesi. Gabime jo materiale, ortografike, apo mungesa që nuk prekin vlefshmërinë apo thelbin, nuk përbëjnë arsye për mos-marrjen në shqyrtim të apelimit. Ankimi dorëzohet pranë zyrës së protokollit të Bashkisë drejtpërdrejtë nga taksapaguesi ose nëpërmejt shërbimit postar.

c. Dokumentacioni shoqërues

Dokumentacioni shoqërues që i bashkëngjitet ankimit duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

1. emrin dhe adresën e taksapaguesit,
2. numrin identifikues të regjistrimit të taksapaguesit,
3. aktin administrativ, të nxjerrë ose të panxjerrë nga organi tatimor, që është objekt ankimi duke përfshirë periudhën tatimore përkatëse dhe shumën e detyrimit tatimor,
4. pagesën e 70 % të detyrimit tatimor që ankimohet (vetëm Bizneset),
5. arsyet për ankimin e tij,
6. informacion në mbështetje të ankimit (Aktin e kontrollit, proces-verbalet, etj.)
7. çdo dokument tjetër që ankimuesi e gjykon të rëndësishëm,
8. nënshkrimin e tij.

d. Pagesa e detyrimit te ankimuar

Në përputhje me Nenin 5, pika ç,v),te Ligjit 9632 “ Për Sistemin e Taksave Vendore”, Këshilli Bashkiak percakton kriteret dhe procedurat e marrdhënieve me taksapaguesit, përfshirë të drejtën e tyre te ankimit.

Ankimi pranohet në qoftë se ankimuesi:

1. parapaguan 70% të detyrimit tatimor, objekt ankimi të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet,
2. vërteton pagesën, duke paraqitur një kopje të dokumentit të pagesës së detyrimit tatimor objekt ankimi.

Në qoftë se taksapaguesi nuk paguan shumën e caktuar para skadimit të afatit të ankimit, ankimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

Në qoftë se nuk plotësohet ndonjë prej kërkesave të përmendura në pikën 4/c Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore i kërkon taksapaguesit ta ridërgojë ankimin e tij të plotësuar si duhet me informacionin e kërkuar brenda 15 ditëve kalendarike.

Taksapaguesi nuk mund te apelojë në gjykatë një akt administrativ që është objekt ankimi në Komisionin Vendor të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, pa patur një Vendim të kësaj strukture lidhur me këtë akt administrativ.

Në rastet kur Komisioni Vendor i Apelimit nuk shprehet brënda 20 ditëve nga data e marrjes së ankimit, taksa paguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë.

5 VEPRIMET E NDËRMARRA NGA KOMISIONI I APELIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

- e. Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore shqyrton dhe merr vendime të pavarura për ankimet e paraqitura nga taksapaguesit. Ai i bazon vendimet e saj në provat dhe argumentet e paraqitura nga taksapaguesi dhe administrata tatimore vendore. Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore mund të kërkojë informacion shtesë, p.sh. dokumente të tjera nga taksapaguesi, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga palë të treta, si dhe mund të bëjë verifikime që ndihmojnë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes.
- f. Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore e kufizon shqyrtimin e ankimit vetëm në çështjet e ngritura nga taksapaguesi në ankim. Në qoftë se gjatë procedurës zbulohen fakte të reja që provojnë se detyrimi tatimor i përcaktuar nuk është i mjaftueshëm, Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk mund ta rrisë vetë detyrimin tatimor. Në këtë rast Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave

Vendore informon me shkrim Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore duke e vënë në dijeni për rrethanat e reja.

- g. Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore ka të drejtë të gjykojë dhe të anullojë gjoba, plotësisht apo pjesërisht, pavarësisht nga vlefshmëria e detyrimit tatimor, në rastet e parashikuara në përputhje me nenin 111 të Ligjit “Për procedurat tatimore”.

Ky gjykim bazohet në analizimin e plotë të arsyeve dhe rrethanave në të cilat është kryer shkelja, duke evidentuar faktet dhe argumentet e mbi bazën e të cilave bëhet gjykimi dhe merret vendimi.

- h. Vendimi i Komisionit të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të përfshijë një shpjegim me shkrim të mënyrës së arsyetimit siç parashikohet në nenin 100 të Ligjit të Procedurave Administrative. Ai nënshkruhet nga Kryetari dhe Anëtarët e Komisionit të Apelimit të Taksave dhe Tarifave vendore.
- 1. Arsyetimi duhet të jetë i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Kur arsyetimi është bërë mbi bazën e informacioneve apo propozimeve të mëparshme, mund të mjaftojë si arsyetim pranimi i tyre nga ana e organit përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar. Në këto raste informacionet dhe propozimet janë pjesë përbërëse e vendimit përfundimtar;
- 2. Vendimi duhet të përfshijë një dispozitë që vë në dijeni taksapaguesin për të drejtën e tij për ankimin e vendimit në gjykatë dhe i dërgohet taksapaguesit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore që ka nxjerrë vendimin objekt ankimi.
- 3. Përdorimi për arsyetim i të dhënave të paqarta, kontradiktore ose të pasakta është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit. Në rastet e çështjeve analoge mund të përdoren arsyetimet e bëra në çështjet e mëparshme.
- i. Pas shqyrtimit të çështjes, Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, vendos:
 - 1. Të refuzojë ankimin për shkak se e konsideron ankimin të papranueshëm;
 - 2. Ta rrëzojë ankimin;
 - 3. Ta anulojë aktin administrativ objekt ankimi duke pranuar ankimin ose
 - 4. Ta pranojë ankimin (pjesërisht ose plotësisht) dhe ta ndryshojë aktin administrativ objekt ankimi.
- j. Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, mund të rrëzojë një ankim në qoftë se:
 - 1. Gjykon që ankimi është i pabazuar pasi procedura është ndjekur sipas rregullit dhe akti administrativ ka qenë i drejtë dhe ligjërish korrekt, ndërsa ankimi është i pabazuar;
 - 2. Zbulon që ka pasur mosveprime (ose gabime të administratës tatimore), por që ato kanë qenë aq të parëndësishme sa që nuk mund ta kenë ndikuar në vendimin administrativ;

3. Akti administrativ është bazuar në ligj, por për arsye të tjera nga ato të shprehura në akt, ajo shpjegon këto arsye në vendim.
- k. Komisioni i Apelit plotëson procedurën dhe eliminon mungesat vetë ose mund t'ia kërkojë këtë gjë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në qoftë se:
 1. Konstaton që faktet në procedurë janë përcaktuar me mungesa dhe gabime;
 2. Konstaton që procedura nuk ka mbajtur parasysh rregullat procedurale që mund të kenë ndikuar aktin administrativ; ose,
 3. Konstaton që përmbajtja e aktit administrativ të kundërshtuar është e paqartë ose bie ndesh me shpjegimet e tij.
1. Komisioni i Apelit në bazë të fakteve të vërtetuara gjatë procedurës, vendos anulimin e aktit administrativ dhe vendos vetë për çështjen ose i kërkon Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore ta zgjidhë atë nëse konstaton që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore:
 1. I ka vlerësuar provat gabimisht;
 2. Ka nxjerrë konkluzion të gabuar nga faktet e parashtruara;
 3. Ligji në bazë të të cilit është marrë vendimi është zbatuar gabimisht;
 4. Komisioni Vendor i Apelit është e mendimit që duhej marrë një vendim i ndryshëm nga ai i marrë.

Ankimuesi mund të heqë dorë nga ankimi para nxjerrjes së vendimit të ankimit. Në këtë rast, procedura e ankimit ndërpritet me një vendim për mbylljen e procedurës së ankimit.

6 AFATI I SHQYRTIMIT TË ANKIMIT NGA KOMISIONI VENDOR I APELIMIT DHE E DREJTA E ANKIMIT KUNDËR VENDIMIT TË KËTIJ KOMISIONI NGA TAKSAPAGUESI

a. Afati i shqyrtimit të ankimit nga Komisioni Vendor i Apelit

Komisioni i Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore vendos brënda 15 ditëve nga dita e marrjes së ankimit. Në qoftë se dita e fundit e këtij afati bie në ditë pushimi apo festë zyrtare, afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës. Në qoftë se ankimi nuk përmbush kriteret formale sipas pikes 4, afati 15-ditor fillon një ditë pas plotësimit të kërkesave formale nga ankimuesi por jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas marrjes së ankimit.

Në asnjë rast koha e shqyrtimit të ankimit nga Komisioni i Apelit nuk mund të kalojë 30 ditë duke filluar nga data e marrjes së ankimit.

Në qoftë se Komisioni i Apelit nuk nxjerr vendim brënda 15 ditësh nga marrja e ankimit të plotësuar si duhet, taksapaguesi mund të fillojë një ankim gjyqësor.

Në qoftë se vendimi i ankimit varet plotësisht ose pjesërisht nga një çështje e mëparshme që është subjekt i procedurave gjyqësore ose është nën juridiksionin e një organi tjetër publik, Komisioni i Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, mund të nxjerrë një vendim të përkohshëm për pezullimin e procedurës deri në zgjidhjen e çështjes së mëparshme.

Gjithashtu, në rastin e pezullimit të një procedure, vendimi përfundimtar i Komisionit të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të nxirret brenda gjashtë muajsh nga data e marrjes së ankimit të plotësuar si duhet.

Përndryshe ankimesi mund të ankimojë drejtpërsëdrejti në gjykatë.

b. E drejta e ankimit kundër vendimit të Komisionit të Apelit

Taksapaguesi ka të drejtë të bëjë ankim në rrugë gjyqësore kundër vendimit të Komisionit të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së këtij vendimi. Megjithatë, në qoftë se taksapaguesi nuk është njoftuar korrektësisht ose nuk ka marrë dijeni për të drejtën e tij për të ankimuar vendimin e Komisionit të Apelit, ankimi në gjykatë bëhet brenda tre muajsh nga data kur vendimi është marrë.

Mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore vetëm në qoftë se Komisioni i Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk nxjerr vendim brenda 15 ditësh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet, ose në rast pezullimi, nuk nxjerr vendim brenda gjashtë muajsh pas marrjes së ankimit të plotësuar si duhet.

7 RIMBURSIMI I DETYRIMIT TATIMOR VENDOR, KAMATËVONESËS DHE/ OSE GJOBËS NE RASTET (E PARAPAGIMIT) NË PROCESIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV

- a. Nëse vendimi i Komisionit Vendor të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore është në favor të taksapaguesit, detyrimi i parapaguar nga taksapaguesi, i rimbursohen taksapaguesit brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi nga ana e Komisionit Vendor të Apelit .
- b. Nëse Komisioni Vendor i Apelit lë në fuqi vendimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe taksapaguesi e pranon vendimin, çdo detyrim tatimor, që përfshin taksën apo tarifën, në rastin kur nuk është paguar, kamatëvonesë dhe çdo gjobë e llogaritur, paguhen nga taksapaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi për ankimin është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga ana e Komisionit Vendor të Apelit.

8 EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË KOMISIONIT TË APELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE APELIMI NË GJYKATË

- a. Vendimi i Komisionit të Apelit ekzekutohet pas njoftimit të këtij vendimi.

- b. Nëse nuk është dakord, me vendimin e Komisionit të Apelimit, taksapaguesi mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brënda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.

Konceptoi: D. Zeraj



KRYETARI

Dritan Leli

